

Përvoja e fituar nga Kongresi i Tretë Botëror i Sindikatave Elektrike

Fedarata e Sindikatave të Pavarura Elektrokozova - FSPE, është anëtare e rrjetit të Sindikatave Elektrike Botërore "**Fuqia Globale Sindikale**". Me datën 18 - 19 Maj 2015, është mbajtur Kongresi i tretë Botëror në Sidnej të Australisë ku kanë qenë të ftuara të gjitha Sindikatet anëtare, në mesin e të cilave edhe BSPK-ja ku ne emer te sajë mori pjesë FSPE nga Kosova. Në Kongres nga FSPE kemi marrur pjesë dy përfaqësues : Fehmi Pajaziti dhe Hajriz Shabani.

Për pjesëmarrje në Kongres jemi nisur me datën 16.05.2015 në mëngjes nga Aeroporti i Sllatinës në këtë relacion: Prishtinë-Stamboll-Dubaj-Sidnej. Në Sidnej kemi mbërritur me datën 17.05.2015 në Mesnatë.

Pjesëmarrja jonë në këtë Kongres , për ne ishte një privilegj nga fakti se ne te marrin pjesë Sindikatat nga Shtetet më të avansuara dhe më të fuqishme si dhe nga fakti se pjesëmarrja në Sidnej kishte një kosto shumë të lartë dhe për neve do të ishte e pamundur të merrnim pjesë, por falë solidaritetit të Sindikatave Australiane, neve na janë mbuluar të gjitha shpenzimet e udhëtimit , ushqimit dhe qëndrimit në Sidnej për pesë ditë të plota. Për këtë, ne ju jemi shumë falenderues dhe mirënjohës Sindikatave nga Australia **ETU** dhe Sekretarit gjeneral të sajë Allen Hicks. Në këtë kongres, kemi premtime nga Sindikatat me te fuqishme se do të na mbështesin në te gjitha sferat e bashkëpunimit, avansimit të veprimit sindikal, si me trajnime dhe seminare te ndryshme në të ardhmen e te tjera.

Edhe delegacioni i FSPE-së nga Kosova pati hapsiren e caktuar për prezentim dhe diskutim ku fillimisht i falenderuam për ndihmen dhe perkrahtjen e dhënë. Prezentuam sfidat dhe te arriturat tona duke i bërë me dije se jemi shteti me i ri dhe se jemi ne proces te konsolidimit por gjithsesi edhe duke i shprehur shqetesimet e tona ne mbrojtjen e te drejtave te punëtorëve, kushteve dhe vendeve të punës së punëtorëve.

Pati interesim nga mediat dhe në kuader të sajë kemi dhënë një intervistë e cila është transmetuar në mediat e Australisë dhe e kanë përcjellë intervisten tonë te të gjithë punëtorët Australiane.

Duke pasur parasysh faktin se ne i takojmi Shtetit më të ri dhe konsolidimi i veprimit sindikal është ne fazën fillestare te konsolidimit te tijë, pjesëmarrja jonë ishte me shumë interes për përfitimin e përvojave të Sindikatave shumë të fuqishme siq janë : Sindikatat nga Danimarka, Australia, Irlanda , Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Suedia dhe shumë të tjera .

Kongresi ka pasur agjendën e caktuar ku me datën 18 dhe 19 Maj 2015 janë mbajtur seancat e punës, prezentimit dhe vendimet e kongresit. Ndërsa me datën 20 dhe 21 Maj 2015 kanë qenë vizitat e planifikuara për pjesëmarrësit e Kongresit.

Në Kongres janë paraqitur të arriturat e secilit shtet dhe esenca ka qenë solidarizimi dhe fuqizimi i interesave të punëtorëve, pastaj diskutimet dhe kampanja e organizuar rreth **kontratave kolektive** ku gjithsesi pjesëmarrëse në hartimin e tyre të jetë Sindikati. Gjithsesi pati edhe diskutime rreth energjisë së ripërtëritshme, industrinë e liftit, mbrojtja dhe siguria në punë si gjëra të rëndësishme.

Prezetime nga ekspertë të lamive të caktuarara si në mbrojtje dhe siguri në punë, energji dhe ripërtëritshme, duke prezentuar edhe statistika të prodhimit të energjisë hidro, termo nga era, kostot e tyre e me radhë. Do të ketë një Web faqe ku një zyrtar i caktuar do të prezentoj diskutimet dhe të arriturat e këtijë rrjeti Sindikal.

Kanë ndodhur shumë gjëra në dëm të punëtorëve në shumë shtete dhe nuk ka pasur informim në sindikatat tjera dhe ky është mesazhi që të informohemi, bashkëpunojmë dhe **të organizohemi në mënyrë globale dhe në mbrojtje të secilit**. Kjo është fuqia globale.

Kongreset e Sindikatave Botrore Elektrike, organizohen për çdo vit dhe në këtë rrjetë bashkëpunimi vendet Skandinave e kanë pasur që nga vitet 90-ta prej nga edhe ka rrjedhur ideja e këtijë rrjeti botror nga vendet organizatore siq janë Danimarka - Irlanda - Australia si grup organizativ bashkë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Për neve si pjesëmarrës nga Kosova në këtë kongres ishte një njoftim ose marrje e informatave (njohurive) rreth organizimit sindikal dhe rrjetit sindikal global botëror.

Prandaj neve na mbetet që përvojën e fituar nga këto tri kongrese sindikale botërore, ta bartim te klasa punëtore në Kosovë. Rreth organizimit sindikal dhe funksionimit të tyre. Për neve në Kosovë është sfida toleranca dhe mosbesimi në Sindikatat që veprojnë në Kosovë. Ndërsa për shtetet e avansuara, të ngritura dhe të zhvilluara këto sfida janë të tejkaluara.

Prandaj na mbetet neve që në të ardhmen të punojmë rreth unifikimit të sindikatave që veprojnë në Kosovë. Sepse është në interes dhe dobi të klasës punëtore në Kosovë.

01.06.2015

Me respekt

FSPE

Kryetari i FSPE-së

Fehmi Pajaziti